

TË REJA SHKENCORE NË BANKËN E SHQIPËRISË

Përmbajtja

1. MATERIALE KËRKIMORE	1
2. AKTIVITETE KËRKIMORE	7
3. LINGJE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA	12

Numri 29 i materialit “Të Rejat Shkencore në Bankën e Shqipërisë” pasqyron disa nga punët kërkimore të sapopërfunduara, punët kërkimore në proces, artikujt, si dhe aktivitetet kryesore kërkimore shkencore të zhvilluara nga ekonomistët e Bankës së Shqipërisë, gjatë gjashtëmuajorit të dytë të vitit 2022.

1. MATERIALE KËRKIMORE

1.1 MATERIALE KËRKIMORE TË PËRFUNDUARA

Kërkimi shkencor në Bankën e Shqipërisë, gjatë kësaj periudhe, është orientuar drejt materialeve dhe analizave empirike me në fokus tema mbi ndryshimet e klimës dhe financën e gjelbër, politikën monetare, stabilitetin financiar, sjelljen e familjeve, metodologjitë e reja mbi big data dhe inteligjencën artificiale etj. Në mënyrë të përmbledhur, ato paraqiten më poshtë.

“Strategjia afatmesme mbi rreziqet klimatike dhe rolin që duhet të luajë Banka e Shqipërisë (2023-2025)”, nga grupi ndërdepartamental i krijuar në Bankën e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim dhe me Bankën Botërore (FinSAC), ideoi në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, strategjinë për financat e gjelbra dhe rrezikun që ato mbartin

për objektivin parësor dhe për objektivat e tjerë të Bankës së Shqipërisë. Qëllimi i kësaj strategjie është që, gjatë një periudhe afatmesme, të kuptohen dhe të vlerësohen plotësisht rreziqet dhe pasojat ekonomike dhe financiare të ndryshimit të klimës, me vizionin për të pasur një sistem bankar të qëndrueshëm, rezistent dhe në mbrojtje të mjedisit. Strategjia, pasi të marrë dakordësinë e Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, do të publikohet në faqen zyrtare të saj, për të pasqyruar planin e veprimit të kësaj strategjie dhe rolin e Bankës së Shqipërisë drejt qëndrueshmërisë në financë, për një ekonomi më të gjelbër dhe më gjithëpërfshirëse.

“Një përjasje metrike sintetike për vlerësimin e zhvillimeve që lidhen me rreziqet e ndryshimeve klimatike, në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor”, nga Gerti SHIJAKU, Departamenti i Kërkimeve (BSH), dhe Pierre MONNIN, Ekonomist, Këshilli për Politikën Ekonomike - CEP

Ky punim ofron një përfaqësim alternativë metrike për të vlerësuar një tregues sintetik të përbërë, të saktë dhe të vazhdueshëm, në lidhje me vlerësimin e rreziqeve të ndryshimeve klimatike në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Metodologjia mbështetet në nevojën për të analizuar rreziqe të tilla nga këndvështrimi për të koordinuar rreziqet fizike dhe ato të ndryshimeve klimatike në tranzicion. Për këtë arsye, ai përfshin një grup të dhënash vjetore që përmbajnë informacion nga 48 tregues, të grupuar në pesë lloje dimensionesh të rreziqeve klimatike, përkatësisht rrezikut akut, kronik, të aftësisë përshatëse, të ekspozimit dhe të rreziqeve zbutëse. Treguesi llogarit peshat e secilës vlerë të normalizuar, duke përdorur metodën e entropisë, si dhe duke e transformuar në një indeks të vetëm me një diapazon nga 0 në 100. Sa më e ulët të jetë vlera e këtij treguesi sintetik, aq më e mirë është performanca në terma të zhvillimeve të rrezikut ndaj ndryshimeve klimatike dhe anasjelltas. Përparësitë e kësaj qasjeje janë të trefishta: së pari, ajo plotëson boshllëqet dhe përmirëson aspektet teknike të indekseve ekzistuese; së dyti, ajo i ndihmon autoritetet të monitorojnë më mirë rrezikun klimatik, në baza të vazhdueshme, dhe të marrin vendime më të mira për zhvillimin kombëtar; së fundi, ndihmon në forcimin e të kuptuarit të rrezikut të ndryshimeve klimatike.

“Një analizë mikro e sjelljes së kursimit të familjeve në Shqipëri”, nga Ola ÇAMI Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Sjellja e kursimit ka një interes të veçantë për politikëbërësit: në terma makroekonomikë, kursimi përfaqëson një burim të rëndësishëm për financimin e investimeve, rritjen ekonomike, si dhe për eficiencën e transmetimit të politikës monetare. Për këtë arsye është i domosdoshëm studimi

i dinamikave të kursimit në nivel mikro. Ky studim përdor të dhënat e Anketës së Pasurisë së Familjeve për të analizuar tre dimensione të sjelljes së kursimit të familjeve në Shqipëri: (1) Kush kursen? - përcaktuesit e vendimit për të kursyer; (2) Si kursen? - instrumentet e zgjedhura për të kursyer; (3) Pse kursen? - motivet e kursimit. Rezultatet sugjerojnë se edukimi dhe kultura financiare luajnë një rol kyç në vendimin për të kursyer dhe në përmbajtjen e portofolit të kursimit.

“Përdorimi i mjeteve “Machine-Learning” për studimin e marrëdhënies ndërmjet prodhimit dhe papunësisë në Shqipëri”, nga Blerina VIKA, Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, Fakulteti Ekonomik (Universiteti i Tiranës), Ilir VIKA, Departamenti i Kërkimeve (BSH), Kozeta SEVRANI, Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, Fakulteti Ekonomik (Universiteti i Tiranës).

Fusha e ekonomisë po përdor gjithnjë e më shumë inteligjencën artificiale për të kompletuar dhe përmirësuar më tej mjetet për analizat dhe vendimmarrjen në të ardhmen. Një nga teknikat e të mësuarit të makinës (ang. *machine-learning*) më të përdorura në parashikimin e treguesve ekonomikë e financiarë është metoda e rrjeteve neurale të përsëritura (RNN), e cila ka provuar shpeshherë të jetë e dobishme në kapjen e jolinearitetit tek seritë kohore statistikore. Ky artikull aplikon teknikën e memories afatshkurtër të gjatë (LSTM), si një nga modelet brenda rrjeteve RNN për të testuar ligjin e Okunit në Shqipëri. Krahas ekzaminimit të lëvizjeve të papunësisë të projektuara nga zhvillimet në kërkesën agregate, ne testojmë nëse dekompozimi i kësaj të fundit në komponentë të ndryshëm të PBB-së sipas metodës së shpenzimeve – një version i dezagreguar i marrëdhënies

së Okunit – ofron parashikime më të mira për ndryshimet e normës së papunësisë. Vlerësimet paraprake brenda-periudhës sugjerojnë se ligji i Okunit mund të qëndrojë në Shqipëri, por reagimi i papunësisë ndaj ecurisë së prodhimit rezulton të variojë gjatë periudhave të ndryshme kohore. Vlerësimet e parashikimeve të modelit jolinear joparametrik tregojnë se luhatjet e normës së papunësisë në gjysmën e dytë të viteve 2010 mund të jenë të lidhura me investimet private dhe shpenzimet e qeverisë, ndërsa ecuria e konsumit privat dhe e tregtisë së jashtme duket se ka ofruar parashikime më të dobëta.

1.2. MATERIALE KËRKIMORE NË PROCES

“A ekziston një marrëdhënie afatgjatë në kërkesën dhe ofertën e huadhënies bankare ndaj firmave (dhe individëve) në rastin e Shqipërisë? Një analizë empirike sipas metodës së vektorit të korigjimit të gabimit”, nga Gerti SHIJAKU, Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Ky punim paraqet një analizë empirike të kërkesës dhe ofertës të kredisë bankare, në rastin e një ekonomie të vogël të hapur si Shqipëria, duke u përqendruar veçanërisht në periudhën pas krizës financiare globale. Duke përdorur të dhëna makroekonomike, ato nga sektori bankar, si dhe nga vrojtimi i aktivitetit kreditues gjatë kësaj periudhe, veçojmë kërkesën dhe ofertën e kredisë në rastin e firmave (dhe familjeve), duke vlerësuar një model dinamik të huasë bankare sipas përqaqjes së disekuilibrit të tregut në të cilën testojmë nëse ekziston një marrëdhënie afatgjatë kointegruese. Grupi i treguesve të përdorur për të specifikuar secilin prej modeleve, si ato të kërkesës dhe

ato të ofertës, përfshijnë besimin ekonomik dhe paritetin e fuqisë blerëse, kushtet e likuiditetit, kostot e mundësive dhe “spread-et”, si ato që lidhen me konkurrencën bankare dhe sjelljen e tyre të kujdesshme, edhe lëvizjet e kursit të këmbimit, janë gjetur të gjitha të integruara të rendit të parë I(I). Kointegrimi u krye me metodën e testit Johansen dhe një përqaqje standarde sipas modelit të Vektorit të Korigjimit të Gabimit u zbatua sipas rezultatit të tij. Rezultatet e modelit tonë mbështesin fuqishëm lidhjen midis efekteve të një treguesi ndaj një tjetri si në periudha afatgjata ashtu edhe në ato afatshkurtra, dhe në secilin rast ekziston një term i korigjimit të gabimit që rrjedh nga lidhja e njohur (e vlerësuar) e kointegrimit afatgjatë që ekziston në secilin rast.

“A ka rëndësi paraaja për parashikimin e çmimeve të konsumit në Shqipëri”, nga Blerina VIKA, Departamenti i Statistikës dhe Informatikës së Zbatuar, Fakulteti Ekonomik (Universiteti i Tiranës) dhe Ilir VIKA, Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Zhvillimet ekonomike gjatë viteve të fundit e kanë nxitur Bankën e Shqipërisë të zgjerojë hapësirën e diskutimit në raportet e strategjisë afatmesme të politikës monetare që nga viti 2019, duke nxitur studimet empirike që të rivlerësojnë përmbajtjen e informacionit të parasë për parashikimin e inflacionit në Shqipëri. Meqë ecuria e treguesve të tjerë makroekonomikë mund të ndikojë lidhjen midis parasë dhe inflacionit në periudhën e afërt dhe atë afatmesme, jemi mbështetur në vlerësimet me metoda statistikore joparametrike, të tilla si rrjetet neurale rekurrente, që lejojnë mundësinë e testimit të marrëdhënive jolineare e të ndryshueshme në kohë. Për këtë arsye, qasja jonë kontribuon gjithashtu në literaturën e përdorimit të inteligjencës kompjuterike

dhe metodave statistikore joparametrike si mjete analitike që mund të mbështesin vendimmarrjen e politikave ekonomike.

Aftësia parashikuese e parasë është vlerësuar për horizonte që variojnë nga tre muaj deri në tre vite. Rezultatet paraprake të modelit me dy ndryshore sugjerojnë se neglizhimi aktual i rritjes së parasë në formulimin e politikës monetare mund të jetë përgjithësisht konsistent me të dhënat statistikore. Megjithatë, krahasimi i modelit të inflacionit me një-ndryshore me modelin me dy-ndryshore mund të sjellë rezultate të njëanshme mbi ndikimin e parasë, për shembull, sepse zhvillimet monetare mund të reflektojnë zhvillime të tjera ekonomike. Në fakt, disa vlerësime paraprake me modele me tre-ndryshore (që përfshijnë inflacionin, rritjen ekonomike dhe të parasë) tregojnë se agregatët monetarë mund të përmbajnë informacion relevant për inflacionin, veçanërisht për horizontet e parashikimit mbi një vit. Gjithashtu, përpjekje të ngjashme me numër më të zgjeruar të inputeve në modelin LSTM sesa ai i sugjeruar nga kriteri i informacionit bajesian shfaqin shenja optimiste për përmirësimin e rezultateve në të ardhmen.

“Kushtet financiare dhe transmetimi monetar në Shqipëri”, nga Meri PAPAANGJELI, Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Nën dritën e zhvillimeve aktuale globale, ku ekonomitë në mbarë botën po përballen me sfidën e rritjes së inflacionit në kontekstin e shtrëngimit të kushteve financiare globale dhe dobësive të mëdha makrofinanciare, monitorimi i kushteve të financimit merr një rëndësi më të madhe në vlerësimin e procesit të transmetimit të politikës monetare dhe përcaktimin e qëndrimit të duhur të saj. Ky

artikull kontribuon në literaturë në disa aspekte: së pari, ai prezanton një indeks të kushteve financiare për Shqipërinë në përputhje me qasjen e FMN-së (që kap ndryshimet strukturore ekonomike dhe mund të përdoret gjithashtu për analiza shumëvendëshe) dhe përveç kësaj, shqyrton rolin e cënueshmërive në sektorin financiar në përcaktimin e transmetimit të goditjeve financiare dhe të politikës monetare në ekonominë reale, duke kapur edhe jolinearitete në këto marrëdhënie. Disbalanca më të mëdha financiare e bëjnë ekonominë shqiptare më të prekshme ndaj goditjeve. Transmetimi i goditjeve financiare dhe të politikës monetare në ekonominë reale varet në mënyrë jolineare nga raporti i kredisë ndaj hendekut të PBB-së, që përdoret si një tregues për “dobësitë” financiare. Gjatë periudhave të cënueshmërive të ulëta financiare, një shtrëngim monetar çon në një ulje të prodhimit dhe çmimeve ekonomike dhe tkurrje të kreditimit. Në të kundërtën, kur cënueshmëritë financiare janë të larta, politika monetare është më pak efektive. Këto gjetje nxjerrin në pah komplementaritetin e politikave monetare dhe makroprudenciale, dhe rolin vendimtar të kësaj të fundit në përbalimin e dobësive të larta financiare, kur politika monetare është më pak efektive.

“Dobësitë financiare të familjeve në vendet e Ballkanit Perëndimor para krizës së shkaktuar nga COVID-19”, nga Elona DUSHKU, Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Kriza e fundit financiare globale dhe kriza pandemike e shkaktuar nga COVID-19 risollën edhe një herë në vëmendje dobësitë financiare të familjeve dhe aftësinë e tyre për të përballuar goditjet që vijnë si rezultat i rënies ose humbjes së të ardhurave ose shpenzimeve të papritura. Duke përdorur të dhënat e valës së tretë të vrojtimit *Life in Transition* (EBRD, 2016) është analizuar

sjellja e 9,000 familjeve të shpërndara në 6 vendet e Ballkanit Perëndimor. Rezultatet paraprake tregojnë që probabiliteti i familjeve për të qenë të dobët financiarisht është i korreluar negativisht me nivelin e të ardhurave, edukimin, përfshirjen financiare dhe të pasurit aktive reale. Gjithashtu, perceptimet pozitive të familjeve mbi situatën financiare të tyre, por edhe për situatën ekonomike të vendit korrelojnë negativisht me probabilitetin e familjeve për të qenë financiarisht të dobët.

1.3. ARTIKUJ KËRKIMORË

“Analiza e performancës së sistemit bankar shqiptar me metodën e zbrërthimit të ROE (2010 – 2020)”, nga Fiqiri BAHOLLI, Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Në literaturë, performanca bankare konsiderohet kapaciteti i saj për të gjeneruar fitim. Për më tepër, bankat e kanë fitimin si brezin e parë të mbrojtjes në rastet kur ka humbje të paparashikuara. Në të njëjtën kohë, si çdo biznes fitimprurës, përfitueshmëria është qëllimi final që kënaq investitorët. Ky artikull synon të studiojë dhe analizojë performancën dhe rezultatet financiare të sistemit bankar shqiptar me metodën e zbrërthimit të normës së kthimit nga kapitali aksioner (ROE) për dhjetëvjeçarin 2010–2020. Analiza e të dhënave bankare gjatë periudhës 2010-2020 tregoi që bankat karakterizohen nga rezultate pozitive të normave të kthimit nga kapitali aksioner, mbështetur nga rritja e veprimtarisë të aktiveve të sistemit, duke sjellë një përdorim më efektiv të tyre. Megjithatë, edhe gjatë këtij dhjetëvjeçari të fundit, rreziku i kredisë ka luajtur një rol të rëndësishëm në përcaktimin e fitimeve të bankave, duke sjellë veprime të ristrukturimit

dhe fshirjes së kredive të këqija, duke orientuar diversifikimin e portofolit të aktiveve të bankave.

“Përdorimi i mjeteve dhe metodave të Big Data për të shqyrtuar tendencat e çmimeve të banesave në Shqipëri”, nga Orion GARO, Departamenti i Kërkimeve (BSH)

Çmimet e banesave në Shqipëri, qoftë në aspektin e ekuilibrit apo të dinamikës së tyre, mbeten të pashqyrtuara mjaftueshëm në lëmin e kërkimeve ekonomike. Ky projekt kërkimor vendosi objektivin e investigimit të sjelljes se ecurisë së tendencave të çmimeve, duke përdorur të dhëna të gjendura në web nga informacioni i gjeneruar nga përdoruesit. Në këtë kontekst, kërkimi analizon listimet online të çmimeve për banesat në shitje, në të gjitha vendndodhjet gjeografike të vendit, duke vlerësuar një indeks mujor të mesatares së çmimeve në kryeqytet, dhe duke e krahasuar dinamikën e tij me të njëjtat llogaritje për të dhënat në mbarë vendin, dhe të dhënat e kategorizuara sipas vendndodhjes gjeografike, konkretisht, bregdet dhe zonat qendrore. Indeksi i vlerësuar merr në shqyrtim një hark kohor prej 5 ½ vitesh, dhe tregon për një trend të përgjithshëm rritës të çmimeve, me një prirje eksponenciale, veçanërisht pas goditjeve të njëpasnjëshme që ekonomia shqiptare përjetoi në vitet 2019 dhe 2020.

ARTIKUJ KËRKIMORË NGA BANKA TË TJERA QENDRORE

“Implikimet e aktiveve digjitale në stabilitetin financiar” nga Pablo D. Azar, Garth Baughman, Francesca Carapella, Jacob Gerszten, Arazi Lubis, JP Perez-Sangimino, David E. Rappoport, Chiara Scotti, Nathan Swem, Alexandros Vardoulakis dhe Aurite Werman, FED

Vlera e aktiveve në ekosistemin digjital është rritur me shpejtësi gjatë një periudhe të karakterizuar nga volatiliteti i lartë. A krijon sistemi financiar digjital sfida të reja potenciale për stabilitetin financiar? Ky artikull analizon këtë pyetje, duke përdorur metodologjinë e FED për analizimin e vulnerabiliteteve në sistemin tradicional financiar. Së fundmi, ekosistemi i aktiveve digjitale ka treguar se është i brishtë. Megjithatë, goditjet negative në tregjet e aktiveve digjitale kanë pasur përcjellje të kufizuar në sistemin financiar tradicional. Aktualisht, ekosistemi i aktiveve digjitale nuk ofron shërbime financiare të rëndësishme jashtë ekosistemit dhe shfaq ndërlidhje të kufizuara me sistemin financiar tradicional. Artikulli përshkruan vulnerabilitetet që mund të shfaqen dhe që mund të paraqesin rreziqe për stabilitetin financiar në të ardhmen nëse ekosistemi i aktiveve digjitale bëhet më sistemik.

<https://www.federalreserve.gov/econres/feds/the-financial-stability-implications-of-digital-assets.htm>

“A do të rrisë tranzicioni jeshil presionet inflacioniste? Pritshmëritë kanë rëndësi”
nga Alessandro Ferrari dhe Valerio Nispi Landi, BQE

Autorët analizojnë një rritje graduale të taksës mbi emetimet në një model “Kejnsianist të Ri” me dy periudha. Ata gjejnë se rritja e taksës sot ushtron presione inflacioniste, por pritshmëritë për një rritje të mëtejshme të taksës nesër ulin kërkesën agregate sot, duke ushtruar presion në rënie mbi çmimet: autorët tregojnë se efekti i dytë është më i madh. Megjithatë, nëse familjet nuk parashikojnë një rënie të të ardhurave në të ardhmen (për shkak se ato nuk janë racionale ose qeveria nuk është e besueshme), efekti

i përgjithshëm i tranzicionit mund të jetë inflacionist në periudhën e parë. Autorët e zgjerojnë analizën në një model DSGE dhe konstatojnë përsëri se tranzicioni i gjelbër është deflacionist. Po ashtu si më sipër, në këtë model, duke zbutur supozimin e pritjeve racionale, ata tregojnë se tranzicioni mund të sjellë fillimisht rritje të inflacionit.

<https://www.ecb.europa.eu/pub/pdf/scpwps/ecb.wp2726~3e04b5ba5d.en.pdf>

“Shpërthimi inflacionist i 2021–22: Si dhe pse erdhëm këtu?” nga Ricardo Reis, BIS

Angazhimet aktuale institucionale të politikës monetare sollën për më shumë se dy dekada një inflacion të ulët dhe të qëndrueshëm. Megjithatë, bankat qendrore nuk arritën të parandalonin një shpërthim të inflacionit në 2021-2022. Ky artikull analizon katër hipoteza paraprake se pse ndodhi kjo. E para është një diagnozë e gabuar e natyrës së goditjeve gjatë një kohe pasigurie të madhe, e cila çoi në një tejzgjatje të politikës ekspansioniste. E dyta është një neglizhencë ndaj informacionit mbi pritshmëritë e agjentëve, e nxitur nga një besim i fortë se pritjet e inflacionit ishin të ankoruara fort dhe se rritja e inflacionit do të ishte e përkohshme. E treta është një mbështetje e tepruar në kredibilitetin e saj në të shkuarën, duke krijuar një iluzion se kishte më tepër hapësirë për t’u fokusuar në rimëkëmbjen e aktivitetit real dhe parashikimin e pasaktë në kahun e poshtëm të inflacionit. E katërta është një rishikim i strategjisë që i bëri bankat qendrore tolerante ndaj inflacionit më të lartë, për shkak të trendit rënës të kthimit të letrave me vlerë të qeverisë, edhe pse kthimi i kapitalit privat qëndroi i lartë.

<https://www.bis.org/publ/work1060.pdf>

“Korniza të stabilitetit makrofinanciar: eksperiencia dhe sfida” nga Claudio Borio, Ilhyock Shim dhe Hyun Song Shin, BIS

Duke filluar nga kriza e madhe financiare 2008–9, ekonomitë e zhvilluara kanë përdorur politika monetare dhe makroprudenciale për të arritur stabilitetin makroekonomik dhe atë financiar. Ekonomitë e tregut në zhvillim gjithashtu kanë ndërlidhur instrumentet e normës së interesit me ndërhyrjen në kursin e këmbimit, politikën makroprudenciale dhe, ndonjëherë, instrumentet për menaxhimin e fluksit të kapitalit për të adresuar sfidat nga fluksi i kapitalit dhe luhatshmëria e kursit të këmbimit. Ky dokument ofron një përmbledhje të përdorimit të politikës

monetare, makroprudenciale dhe të kursit të këmbimit, ndonjëherë krahas menaxhimit të fluksit të kapitalit, si në ekonomitë e zhvilluara ashtu edhe në ekonomitë e tregut në zhvillim. Ai gjithashtu vlerëson shkallën në të cilën përdorimi i këtyre politikave përbën një kornizë gjithëpërfshirëse të stabilitetit makrofinanciar. Autorët arrijnë në tre përfundime. Së pari, kombinimi i mjeteve ka pasur sukses në përmirësimin e trade-off-it të politikave, veçanërisht duke zbutur rreziqet ndaj stabilitetit të brendshëm që rrjedhin nga sektori i jashtëm. Së dyti, arritja e një stabiliteti makrofinanciar gjithëpërfshirës është ende një punë në progres. Së fundi, duhen bërë më shumë përpjekje për të kuptuar më mirë kanalet e përhapjes ndërkombëtare dhe ngërçeve.

<https://www.bis.org/publ/work1057.pdf>

2. AKTIVITETE KËRKIMORE

2.1 TAKIMI I 16-TË I KËRKIMEVE EKONOMIKE PËR EVROPËN JUGLINDORE

Në datat 5-6 dhjetor 2022, Banka e Shqipërisë organizoi Takimin XVI të Kërkimeve Ekonomike për Evropën Juglindore. Takimi i organizuar në formën e një forumi diskutimi të punëve dhe projekteve kërkimore të kryera gjatë vitit 2022, synon të nxisë shkëmbimin e pikëpamjeve midis kërkuesve të Bankës së Shqipërisë dhe kërkuesve nga bankat qendrore të rajonit e më gjerë, mbi rezultatet dhe implikimet e kërkimit shkencor për çështjet e lidhura me aktivitetin e bankave qendrore.

Më poshtë është lista e materialeve të prezantuara në këtë takim:

- *Në kërkim të Neo-Fisher: një model të recesionit të nxitur nga shpirti i kafshëve*, nga Jacob Robbins (Universiteti i Illinoisit, SHBA)
- *Kanali i përbërjes të monedhës së politikës monetare dhe roli i rregullimit makroprudencial*, nga Kyriakos Neanidis, Christos S. Savva (Universiteti i Mançesterit, MB)
- *Kuptimi i dinamikës së inflacionit: Roli i shpenzimeve qeveritare*, nga Yinxi Xie, Chang Liu (Banka e Kanadasë; Universiteti Kombëtar i Singaporit)
- *Paraja dixhitale dhe operacionet e bankës qendrore*, nga Charles Kahn, Manmohan Singh, Jihad Alwazir (FMN)
- *Vlerësimi i hendekut të prodhimit*

- dhe politika monetare me njohuri jo-perfekte, nga Pei Kuang, Kaushik Mitra, Li Tang (Universiteti i Birmingham, MB)
- **Flluskat e tregut të aksioneve dhe politika monetare: një analizë Bayesian,** nga Arthur Galichere (Universiteti i Warwick, MB)
 - **Dinamikat e familjeve që kursejnë në një ekonomi Keynesianiste të re, me agjentë që mësojnë vazhdimisht në kohë,** nga Matteo Bondesan (ECB, Universiteti i Torinos; Collegio Carlo Alberto, Itali)
 - **Politika monetare në një model me dy vende me agjentë të sjelljes,** nga Michal Brzoza-Brzezina, Paweł Galiński, Krzysztof Makarski (Banka Kombëtare e Polonisë)
 - **Dinamika jolineare në pritjet e inflacionit: Dëshmi nga Turqia,** nga Omer Cayirli, Koray Kayalidere, Huseyin Aktas (Universiteti Manisa Celal Bayar, Turqi)
 - **Bilanci i bankës qendrore dhe inflacioni në një ekonomi të vogël të hapur të euroizuar me tregje të kufizuara kapitale,** nga Gent Sejko, Altin Tanku (Banka e Shqipërisë)
 - **Një analizë empirike mbi normat e inflacionit të vëzhguara pas pandemisë COVID-19,** nga Gulgun Arikan (Universiteti Bogazici, Stamboll, Turqi)
 - **Spread-et e obligacioneve të qeverisë të vendeve në zhvillim të Ballkanit: Faktorë shtesë janë në lojë,** nga Arjan Kadareja, Ardita Todri (Universiteti i Nju Jorkut, Tiranë)
 - **Bankat zëvendësuese: efektet në investime,** nga Francesco Bripi (Banka e Italisë – zyra në Milano)
 - **Cikli i buxhetit politik – ka rëndësi pjesëmarrja në programet e FMN-së?,** nga Drini Imami, Endrit Lami (Universiteti Bujqësor i Tiranës; Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Shqipëri)
 - **Arti i dirigjimit të makropru,** nga Yannick Lucotte, Florian Pradines-Jobet (Universiteti i Orléans, Francë)
 - **Pse të ndiqni Fed-in? Politika monetare në kohën e shtrëngimit të SHBA-së,** nga Gonzalo Huertas (FMN)
 - **Remitancat në kohë krize: dëshmi nga korridoret italiane,** nga Alessio Ciarlone (Banka e Italisë)
 - **Çfarë i shtyn ndryshimet e indeksit të çmimeve të konsumit: një analizë empirike e një përzgjedhjeje të vendeve të Ballkanit Perëndimor,** nga Flora Merko, Ermira H. Kalaj, Alma Zisi (Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës; Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkodër, Shqipëri)
 - **Drejtimi i përhapjeve në EMU: Dëshmi nga kriza e borxhit sovran të BE-së,** nga Pietro Bompreszi, Filippo Passerini (Università Cattolica del Sacro Cuore, Milano, Itali)
 - **A janë vërtet femrat më pak të kulturuara financiarisht se meshkujt? Mbi problemet metodologjike për matjen e njohurive,** nga Paweł Kuśmierczyk, Radosław Kurach, Marek Kośny (Universiteti Wroclaw, Poloni)
 - **Dëshmi mbi brishtësinë financiare të familjeve në vendet e Ballkanit Perëndimor para COVID-19,** nga Elona Dushku (Banka e Shqipërisë)
 - **Një mikroanalizë e sjelljes së kursimeve të familjeve në Shqipëri,** nga Ola Çami (Banka e Shqipërisë)
 - **Fluturimi drejt sigurisë klimatike: fatkeqësitë natyrore lokale dhe rialokimi global i portofolit,** nga Fabrizio Ferriani, Andrea Gazzani, Filippo Natoli (Banka e Italisë)
 - **Bankat qendrore dhe politika klimatike: Shkëmbime të pakëndshme? Një qasje kryesore-agjenti,** nga Donato Masciandaro, Riccardo Russo (Universita Luigi Bocconi, Itali; King's College në Londër, MB)
 - **Rreziqet klimatike në Shqipëri dhe rëndësia e tyre për Bankën Qendrore,** nga Margerita Topalli, Pierre Monnin (Banka e Shqipërisë; Këshilli për Politikat

Ekonomike - CEP)

- **Një vlerësim i rrezikut të lidhur me ndryshimet klimatike në rastin e vendeve të Ballkanit Perëndimor**, nga Gerti Shijaku, Pierre Monnin (Banka e Shqipërisë; Këshilli për Politikën Ekonomike - CEP)
- **Politikat makroprudenciale dhe marrja e rrezikut nga bankat nën mjedisin me norma të vazhdueshme të ulëta interesi**, nga Jose D. Garcia Revelo (Univ. Orléans, LEO, Orléans, Francë)
- **A ka rëndësi paraja për parashikimin e çmimeve në Shqipëri?**, nga Blerina Vika, Denada Xhaja, Ilir Vika (Universiteti i Tiranës; Banka e Shqipërisë)
- **Kredia, kushtet financiare dhe politika monetare**, nga Meri Papavangjeli (Banka e Shqipërisë)
- **Kredia për pasuritë e patundshme, kredia e korporatave dhe ekonomia reale: Evidencë empirike**, nga Bledar Hoda (Banka e Shqipërisë)

Ndërsa në poster sesion u prezantuan materialet e mëposhtme:

- **Militarizimi dhe pabarazia e të ardhurave në vendet evropiane (2000-2017)**, nga Raul Caruso, Antonella Biscione (Universiteti Katolik "Zoja e Këshillit të Mirë", Tiranë)
- **Kreditë me probleme dhe sjellja e huadhënies bankare**, nga Ardit Gjeçi, Matej Marinč, Vasja Rant (Universiteti i Nju Jorkut, Tiranë; Universiteti i Ljubljanes, Slloveni)
- **Privimi, konsideratat e lëvizshmërisë dhe kënaqësia nga jeta: Një studim krahasues i 33 vendeve evropiane**, nga Elvira Drishti, Edvin Zhllima, Blendi Gerdoçi (Universiteti i Shkodrës; Universiteti Bujqësor i Tiranës; Universiteti i Tiranës)
- **Menaxhimi i rrezikut të klimës dhe bankat në Shqipëri**, nga Lindita Molishti (Banka e Shqipërisë)

- **Analiza e sistemit bankar shqiptar, duke përdorur metodën e dekompozimit të ROE**, nga Fiqiri Baholli (Banka e Shqipërisë)
- **Përdorimi i mjeteve të Big Data për të pyetur mbi tendencat e çmimeve të banesave rezidenciale në Shqipëri**, nga Orion Garo (Banka e Shqipërisë)

2.2 SEMINARI I SË PREMTE

Seminari me temë **"Matja e avancuar e prodhimit dhe procesit të inovacionit: Aplikime për produktivitetin dhe rritjen"**, nga Dr. Elvira SOJLI, Professore e Asociuar e Financës në UNSW Business School, Sydney, Leo Liu (University of New South Wales); Wing Wah Tham (University of New South Wales), shtator 2022

Autorët propozojnë një matje të ndryshme në kohë për prodhimin e avancuar dhe procesin e inovacioneve të bazuara në pretendimet dhe titujt e shpikjeve të patentave nga 1850 deri në 2019, në 51 vende. Duke përdorur këtë masë, autorët ofrojnë dëshmi se këto risi janë të rëndësishme për rritjen ekonomike të firmës dhe ekonomisë në tërësi, nëpërmjet përhapjes teknologjike në inovacionet e produkteve dhe rritjes së përfitimit. Autorët gjejnë se patentat me procese të avancuara kanë citime më të shumta në të ardhmen dhe vlerë ekonomike më të lartë sesa patentat e produkteve të së njëjtës klasë dhe grup teknologjike. Firmat me një proces inovacioni të një cilësie të lartë kanë më shumë fitime, shitje, kapital, punësim dhe produktivitet total të faktorëve në periudhën afatshkurtër, ndërsa inovacioni i produktit luan një rol më të madh në terma afatgjatë. Në nivel agregat, si prodhimi i avancuar ashtu edhe inovacionet e produkteve janë të lidhura pozitivisht me rritjen ekonomike të SHBA-së.

2.3 SEMINARI TEKNIK

Gjatë periudhës korrik-dhjetor të vitit 2022, janë zhvilluar seminarët e mëposhtme:

Seminari me temë **“ABC e kërkimit shkencor”** nga Dr. Elvira SOJLI, Professore e Asociuar e Financës në UNSW Business School, Sydney dhe presidente e FIRN (Financial Research Network)

Seminari me temë **“Analiza e performancës së sistemit bankar shqiptar me metodën e zbërthimit të ROE (2010 – 2020)”**, nga Fiqiri BAHOLLI, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

Seminari me temë **“Një analizë mikro mbi sjelljen e kursimit në Shqipëri”**, nga Ola ÇAMI, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

Seminari me temë **“Një përfaqje metrike sintetike për vlerësimin e zhvillimit të qëndrueshëm në rastin e Shqipërisë”**, nga Gerti Shijaku (Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë) dhe Pierre Monnin (Ekonomist, Këshilli për Politikën Ekonomike - CEP)

2.4 ÇMIMI I GUVERNATORIT PËR DIPLOMËN MË TË MIRË PËR VITIN 2022

Banka e Shqipërisë, edhe për vitin 2022, organizoi konkursin e hapur “Çmimi i Guvernatorit për diplomën më të mirë”, për të inkurajuar studentët e fushës së ekonomisë, si brenda dhe jashtë vendit, për t’u angazhuar në punë cilësore kërkimore shkencore.

Në konkursin e këtij viti morën pjesë 16 studentë, me tema masteri që trajtojnë fenomene të ndryshme që lidhen drejtpërsëdrejti apo në mënyrë indirekte me bankat qendrore. Me çmimin e parë u vlerësua zj. Pegi Myshqeri, studente në Universitetin Goethe, në Frankfurt, Gjermani, për temën “Efektet e blerjes së aktiveve nga BQE-ja në tregjet evropiane të obligacioneve të korporatave”. Me çmimin e dytë u vlerësua z. Taulant Yzellari, student në Universitetin e Këlnit, Gjermani, për temën “Dinamikat ndërkombëtare të çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe makroekonomia”. Ndërsa me çmimin e tretë u vlerësua z. Ilir Brasha, student në Universitetin e Tiranës, për temën “Ndikimi i shpenzimeve qeveritare në rritjen ekonomike, madhësia e multiplikatorit. Rasti i Shqipërisë”,

2.5 PJESËMARRJA NË AKTIVITETE TË TJERA

PREZANTIM NË KONFERENCËN E BCC-SË NË GJENEVË, 22-23 SHTATOR 2022

Në këtë konferencë morën pjesë përfaqësuesit e Bankës së Shqipërisë, të cilën prezantuan dhe paraqitën rezultatet e materialeve të mëposhtme:

- **“Bilanci i Bankës Qendrore dhe inflacioni në një ekonomi të vogël, të hapur, të euroizuar, me tregje të kufizuara kapitale”**, Gent SEJKO (Guvernator, Banka e Shqipërisë) dhe Altin TANKU (Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë)

Ky studim synon të hetojë nëse ndryshimet në strukturën e bilancit të BSH-së sjellin goditje monetare shtesë me efekte të drejtpërdrejta në inflacion dhe në aktivitetin ekonomik. Hipoteza kryesore është se ndryshimet në strukturën e bilancit të BSH-së në favor të komponentëve jobankë (dhe, në mënyrë ekuivalente, ndryshimet e bazës monetare në favor të parasë jashtë bankave) sjellin goditje shtesë të ofertës monetare përtej dhe mbi efektet tradicionale ekspansioniste të normës së politikës. Identifikimi i goditjeve strukturore në modelin VAR, udhëhiqet nga dy njohuri të rëndësishme: së pari, karakteristikat e veçanta të procesit të gjenerimit të të dhënave mund dhe duhet të merren parasysh në strukturën e modelit; së dyti, mbështetemi në njohuritë tona mbi procesin e vendimmarrjes, siç përshkruhet në raportet vjetore dhe ato të politikës monetare të Bankës së Shqipërisë.

- ***“Kombinim i qasjes monetare, fiskale dhe strukturore, për modelimin e inflacionit në Shqipëri”***, nga Meri PAPA VANGJELI (Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë)

Në kontekstin aktual të pasigurive të larta në ekonominë botërore dhe rritjes globale të çmimeve, ky artikull hulumton empirikisht faktorët përcaktues të inflacionit në Shqipëri, përmes një qasjeje strukturore, duke konsideruar veçanërisht zhvillimet në sektorin e ushqimeve në përgjithësi dhe atë të drithërave në veçanti, për periudhën nga viti 2000 deri në tremujorin e parë 2022. Duke marrë parasysh katër

matje të inflacionit si: çmimi i drithërave, ushqimeve, çmimi i artikujve joushqimorë dhe inflacioni tërësor, studimi analizon faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të inflacionit, duke përfshirë faktorët e anës së kërkesës, ofertës dhe faktorë strukturore, përmes një modeli të korigjimit të gabimit, i cili lejon kapjen e efekteve afatshkurtra dhe afatgjata.

- ***“Implikimet e lehtësirave sasiore të Bankës Qendrore Evropiane për një ekonomi të vogël dhe të hapur”***, nga Bledar HODA (Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë)

Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi i madhësisë relative të politikës monetare tradicionale dhe jokonvencionale të Bankës Qendrore Evropiane (BQE) në dinamikën e ekonomisë shqiptare, pas krizës financiare globale të vitit 2008. Rezultatet tregojnë që zgjerimi ekzogjen i bilancit të BQE-së ka përmirësuar kushtet financiare të Shqipërisë, nëpërmjet një kanali operativ financiar. Goditjet jokonvencionale të BQE-së kanë rezultuar në një rënie të termit shtesë të rrezikut të letrave me vlerë të qeverisë, rënie të lehtë të rrezikut shtesë së vendit, por edhe në një vlerësim të monedhës vendase. Së fundi, konkludohet se mekanizmi kryesor i këtyre efekteve është kanali i ribalancimit të portofoleve dhe se goditjet e politikave monetare jokonvencionale shkaktojnë përgjigje negative të flukseve të kapitalit, të cilat transmetohen në ekonominë reale.

3.LINQE TË INSTITUCIONEVE TË TJERA:**Banca d'Italia**

[\(http://www.bancaditalia.it/studiricerche/\)](http://www.bancaditalia.it/studiricerche/)

Bank of Canada

<http://www.bankofcanada.ca/research/>

Banco de Espana

<http://www.bde.es/informes/be/docs/docse.htm>

Bank of England

<http://www.bankofengland.co.uk/publications/workingpapers/index.htm>

Bank of Finland

http://www.bof.fi/en/julkaisut/bofit_julkaisut/index.htm

Bank of Greece

<http://eng.bankofgreece.gr/en/publications/research.asp>

BIS Central Bank Research Hub

<http://www.bis.org/cbhub/index.htm>

Czech National Bank

[\(http://www.cnb.cz/en/research/\)](http://www.cnb.cz/en/research/)

Deutsche Bundesbank

http://www.bundesbank.de/vfz/vfz_diskussionspapiere_2009.en.php

European Central Bank

<http://www.ecb.int/home/html/researcher.en.html>

Federal Reserve

<http://www.federalreserve.gov/econresdata/default.htm>

International Journal of Central Banking

<http://www.ijcb.org/>

National Bureau of Economic Research

<http://www.nber.org/>

International Monetary Fund

<http://www.imf.org/external/pubind.htm>

Oesterreichische Nationalbank

http://www.oenb.at/en/presse_pub/research/research.jsp